



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK

PROJEKTVENDIM

Nr.____ , Datë ____/____/2026

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT PËR BASHKINË DURRËS
PËR VITET 2026-2028

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligjit nr.152/2013 “Për nënpunësin civil” i ndryshuar, Ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, i ndryshuar, Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksionit shtetëror”, Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, Ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin me publikun”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 859, datë 26.12.2024 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit 2024-2030, planit të veprimit 2024-2026 në zbatim të saj dhe pasaportës së treguesve të performancës”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 20.4.2023 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030, të planit të saj të veprimit 2023–2025 e të pasaportës së indikatorëve”, Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, dhe sipas relacionit të hartuar nga Grupi i Punës për hartimin e planit të integritetit për bashkinë Durrës për vitet 2026-2029, i ngritur me Urdhër të kryetares së bashkisë nr.35, datë 02.02.2026, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e Planit të Integritetit për Bashkinë Durrës për vitet 2026-2028, i cili është pjesë integrale e këtij projektvendimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha Drejtoritë e Bashkisë Durrës dhe Institucionet e ndërmarrjet në varësi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

DREJTORIA JURIDIKE

Drejtore

Alneida Rroshi

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Drejtore

Brunilda Gripshi

KRYETARE

Emiriana Sako